



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 507/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.507/2021, të datës 15.02.2021, nga organizata joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021.

A r s y e t i m

Me datën 15.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën nga BIRN dhe IKS, me të cilën pretendohet se një zyrtar nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka thyer heshtjen zgjedhore duke publikuar një fotografi në story, me të cilën ka bërë thirrje për të votuar subjektin politik PDK-në. Më tutje në ankesë pretendojnë se ky veprim bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat Zgjedhore si prove kanë ofruar dy fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK të datës 16.02.2021 konsiderojnë se ankesa e parashtruar nga BIRN dhe IKS nuk qëndron pasi që në fotografitë e printuara si provë nuk saktëson datën e publikimit, por shihet vetëm ora e telefonit dhe asgjë tjetër. Më tutje në përgjigje në ankesë të subjektit politik PDK theksohet se zëdhënës i partisë nuk është z. Valmir Klaiqi, por është z. Avni Bytyqi.

Subjekti politik PDK, propozon PZAP-in që ankesën ta hedh poshtë si të pabazuar.

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kane ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka thyer heshtjen zgjedhore, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës parashtruesi i ankesës BIRN dhe IKS nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij se subjekti politik PDK, se është përgjegjëse për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartëcekura nuk ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të padyshimt, se pretendimet ankimore janë të pabazuar në ligj sepse të njëjtat, nuk mbështeten me asnjë provë bindëse nga parashtruesi i ankesës, andaj ankesa e ankuesit u refuzua si e pabazuar në kuptim të nenin 118 të LZP-së.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.507/2021 më datën 16.02.2021

**Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.